



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 29.03.2017 (E Merkur) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Daut Xhemajli Selvije Rexhepi, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoj Arbëresha Ibrahimimi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe kompaninë “Pro Ing” që është sot prezent. Më lejoni të ju informoj. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtroj pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

z.Nuredin Lutfiu: Të nderuar koleg asamblast! Kërkesë: Komiteti mysliman i qytetit të Vitisë, mbështetur nga Këshilli i Xhamisë së Vitisë dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Viti, kërkojnë nga kryetari i Komunës nga Kuvendi Komunal, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, që të ndaj një lokacion për ndërtimin e një xhamie në qytetin e Vitisë, sepse xhamia ekzistuese nuk i plotëson nevojat e këtij komuniteti.

z.Mirlinda Sadiku: Atë ditë në KPF patë një kërkesë, që në fakt ju kishte drejtuar komunës qysh në vitin 2010 për personat me aftësi të kufizuar. Nënkryetar, a është punuar dicka në këtë

drejtim? Kam dëshirë të kem përgjigje nga Drejtori i Inspeksionit, është mjaft shqetësuese lajmi që është publikuar, se janë konfiskuar me një biznes privat diku rreth 600 kg mish, nëse ke mundësi me na dhanë informacione ma shumë dhe po ashtu kisha kërkuar që të inspektohen ato dyqane, sidomos të cilat janë përreth shkollave që fëmijët blejnë aty, që dyshohet se ka gjësende me afat të skaduar. Po ashtu kam pyetje për drejtorin e Arsimit; Drejtor, sipas faqes zyrtare të Komunës, është publikuar me 08.03.2017, prapë ka shukua në ri shpallje drejtori i Cerdhes: pse ka ndodhur kjo? Po ashtu edhe për shkollën “Mirali Sejdiu”, si dhe gjithashtu kam pyetje, vetëm jeni i njoftuar për kulmin në fshatin Skifteraj, te shkolla: cka ka ndodh me të, pse nuk po punohet? dhe e di se firma kontraktuese duhet ta kryej si obligim, po ashtu fondacioni nuk e ka pranuar teknikisht ata kulm, po ashtu konkursi publik për ndarjen e bursave është publikuar me 09.11.2016, kam bërë pyetje shumë herë, me ke thanë për shkak se studentët kanë edhe bursa universitare, ndërsa prej universiteti ende nuk është verifikuar lista që 5 muaj, qytetaret edhe studentet po presin.

z.Bekim Azizi: Kisha bë pyetje: sa është duke u përcjell rregullimi i ujësjellësit në Smirë dhe në Verban? Sinqerisht po them, hapja e kanalit rreth asfaltit është duke e motuar asfaltin dhe për shkak të makinerisë së rënd që është duke punuar aty. I përcjella do asfalte se janë shtruar nëpër qytet edhe vendet ku janë prish ato asfalte ka vende ku vetëm një centimetër është trashësia e asfaltit po edhe 2 apo 2,5 që i kemi bërë do matje, mirëpo në ato vende është mbuluar me do zall dhe ju qitet vetëm një far nxifti, nuk e di kjo formë si është lejuar. Kam bërë kërkesë për me shti pikë të rendit të ditës “Eko Higjienën” nuk e keni sjell, ju jeni duke e pa se nuk është duke funksionuar çështja e mbeturinave, mirëpo prapë nuk e di, se drejtori i Inspeksionit a i ka përcjell hedhjen e mbeturinave, sidomos mbi fshatin Smirë është tu ndodh me të madhe dhe është një ndotje jashtëzakonisht e madhe.

z.Adnan Ymeri: Propozoj se për seancën e ardhshme të jetë si pikë e rendit të ditës debat lidhur me çështjen e kompanisë së mbeturinave “Eko Higjiena” dhe te dalin me vendime konkrete. Arsye kryesore është, se kjo kompani nuk e kryen punën si duhet në Komunën tonë, te hyra ka te mjaftueshme, ndërsa për çdo ditë, por edhe me herët në këtë kompani ka pasur diskriminim te të drejtave te punëtorëve, së fundi e njëjta, tre punëtorë pa arsyetim i largon nga puna, ne mesin e tyre do te thotë edhe kryetarin e sindikatës, i cili i kërkon të drejtat e tyre. Një pjesë tjetër i merr në vërejtje, ndërsa te tjerët i detyron të lidhin kontratë për kohë të caktuar, konkretisht për 6 muaj, edhe pse ka të tillë që punojnë qe 40 vite në këtë kompani, ku ky veprim sipas dispozitave ligjore është jashtë ligjor, pastaj kemi edhe rastin që nuk i kanë paguar rrogat e fundit dhe vetëm nga 100 euro ju ka bartur në llogari punëtorëve, gjithashtu vlen të ceket edhe shitja e aseteve që ka qenë anti ligjore, andaj duke i paraparë të gjitha këto veprime dhe anti ligjore e shohë të arsyeshme që ky propozim të hy si pikë e rendit të ditës në seancën e ardhshme dhe Kuvendi Komunal si institucion më i lartë në Komunë të Vitisë të del me rekomandime konkrete.

z.Ali Bajrami: Unë kisha pyetje konkrete për drejtorin e Urbanizmit, pasi që dimë se muaji prill është muaji i mbrojtjes së ambientit, cka ka të paraparë drejtorja e juaj për këtë muaj sa i përket mbrojtjes së ambientit në nivel të Komunës së Vitisë? Dhe pyetja tjetër ka të bëjë me drejtorin e Administratës: ku është arritur me punime në objektin e ri të komunës?

z.Bislim Bislimaj: Unë shumë herë i kam cek problemet e fshatit Drobesh, por kohen e fundit është përhapur një problem ma i ri, tash në lidhje me higjienën e shkollës dhe kushtet e shkollës në fshatin Drobesh. E kam cek edhe më parë, se shkolla e Drobeshit nuk i plotëson as përseafërmi kushtet si për ka sasia e nxënësve në metra katror, si për kushtet higjienike, por tash së fundmi fshataret kanë një mbledhje dhe i kanë cekur të gjitha problemet, po dikush pastaj i ka thirrur mjetet e informimit për me ardhur me vizitu atë dhe së fundi skandali ma i madh që ka qenë nga Drejtoria e Arsimit ka ardhur vendimi, që KTV-ja nëse vjen mos të lejohet me hy aty, nëse ka ardhur puna deri aty, se mjetet e informimit mos me i lejuar me hy aty pa lejen e DKA-së, atëherë me të vërtetë nuk e di se ku jemi duke shkuar.

z.Baki Nebiu: Unë desha me u ndal me bë një pyetje, së fundi memorandumit i bashkëpunimit për mbështetje financiare në projektin e ndërtimit të stadiumit në Viti prej ministrisë, ku është vlera prej 800 mijë euro, këtu në Fcb kur po i publikoni këto investime që po i merrni prej ministrisë është e cekur mjaft kuart që janë nda 800 mijë euro për ndërtimin e stadiumit të Vitisë. Së fundi herë e pash prej faqes zyrtare të Posheranit, klubit të futbollit atje ku aty ceket që gjysma e kësaj shume ka me u investuar në këtë vend, kurse gjysma tjetër me u investuar në qytetin e Vitisë. Unë nuk jam asgjë kundër klubit të Pozheranit, po nëse janë të dedikuara kjo shumë për stadiumin e qytetit këto duhet të jenë vetëm për këtë stadium jo me u nda mandej 2-at me u lanë keq, se me 400 mijë euro s'mund të bëjmë asgjë. Tjetra, banoret e fshatit Kabash qe dy vite e kanë dërguar në Zyrën e Kryetarit një projekt të parkut në Kabash, ku në dakordim me kryetarin janë marrë vesh që kjo të investohet në vitin që e lamë pas, por kjo nuk ka ndodhur po kisha pasur dëshirë ta marr një përgjigje nga ana e juaj nënkryetar në këtë vit a do të investohet në parkun e Kabashit.

Kryesuesi: Meqenëse u shtruan një numër i madh i pyetjeve, ja kisha kalua fjalën drejtoreve.

z.Qahil Sinani: Sa i përket pyetjes së shtruar nga Mirlinda, çështja e drejtorëve. Me udhëzim administrativ e donë, se konkursi parë duhet të jenë tre kandidat, konkursi i dytë dy kandidatë dhe konkursi i tretë një kandidatë, prandaj ashtu u ardhur te shkolla e Gushicës. Tash për tash zgjidhet me një kandidatë, pa marr parasysh sa konkurrojnë. Te çerdhja, gabim teknik është te sekretari, ngase kur e ka formuar komisionin intervistues, atje ka shkruar vetëm për shkolla a nuk e ka cek edhe për çerdhe, prandaj këshilli i lartë gjyqësor a ka anuluar konkursin për çerdhe vetëm për këtë shkak, pra për një gabim teknik. Çështja e kulmit në Skifteraj, është e vërtetë se fondacioni e ka rregulluar, po firma e cila e ka punuar atë ka shtie material të dobët dhe era e ka thye dhe tash ata kanë me intervenuar, kjo çështje është e kryer. Te bursat, është e vërtetë që është bërë një shtyrje e bursave, po na ka shti kjo neve, se ata të cilët kanë konkurruar mos ti marrin dy bursa, bura universitare dhe bursa komunale, për këtë arsye e kemi shty. Sa i përket shkollës në Drobesh kemi bë kërkesë dhe kemi pas kontakt me drejtorin për Infrastrukturë, që të ndërtohet një shkollë e re, por deri sa të rregullohet e reja ne këtë e kemi shti në rivitalizim shkollën ekzistuese. Nuk është e vërtetë se është penguar ndonjë medium, është e vërtetë që kushdo që vjen duhet me u takua me DKA-në, nuk kam dhënë asnjë urdhër për mos me lejua ndonjë medium për me vizitu këtë shkollë.

z.Skender Ahmeti: Një pyetje ishte për konfiskimin e mishit në disa markete tregtare të Vitisë, ka qenë mediatike dhe ne jemi përmirësuar dhe krejt qa e kam thanë në tv KLAN ka qenë reale, përveç se sasia ka qenë ma e madhe se sa 600 kg, por unë nuk kam dashtë ta ndryshoj shifrën që e

ka marr PLUS tv, dhe kemi pas dje, na kemi pas dje prapë inspektor nga Agjensioni i Veterinarisë dhe Ushqimit dhe inspektoret komunal, asgjësimi nuk është bërë edhe dje për shkak se transporti i atij mishi nuk është siguruar nga ato markete që ju ka konfiskua mishi dhe thjesht është një mbeturinë që nuk guxon të asgjësohet si mbeturinat tjera, ndërsa sa i përket asgjësimit nëpër markete afër shkollave, na do të jemi vigjilent, do të inspektojmë, por nëse ka ndonjë parregullsi, se kemi edhe qytetar që vinë edhe ankohen për mallrat me afat të skaduar, na procedojmë lëndë për skadim të afatit. Te hedhja e mbeturinave, që e përmendi Bekimi, në fshatin Smirë, është e vërtetë se jo vetëm në Smirë po në çdo vend ka mbeturina shumë, ne e kemi një udhëzim administrativ që është nxjerr në vitin 2016, por që ka vazhduar që nga viti 2009, po na kërkojmë edhe nga qytetaret që të na ndihmojnë në këtë drejtim me ndonjë foto kur e shini që po hedhin mbeturina. Ne në këtë javë i kemi qar dy lëndë, këtu po e shfrytëzoj këtë foltore, ku kemi rastin edhe në Skifteraj që kanë has qytetaret dhe i kanë bërë fotografitë te hedhjes se mbeturinave, sic është lakra përshembull, që është kalbur dhe është prementu dhe ka kundërmu aromë dhe e kemi procedua.

z.Ajet Sallahu: Drejtorja e Urbanizmit, Sektori Mjedisit, organizon “Ditët e Ambientit”, që është tradicional. Kjo fillon me 3 Prill dhe përfundon me 22 Prill në ditën e Ambientit. Aksioni do të shtrihet duke filluar nga qyteti i Vitisë dhe në të gjitha fshatrat dhe pjesëmarrës do të jenë qytetaret, organizatat e ndryshme shkollat dhe të gjithë qytetaret që janë të interesuar të marrin pjesë në këtë aksion.

z.Isak Sadiku: Në lidhje me punimet, ne kemi formuar komision që i përcjellin punimet, aty ata e kanë një kontratë, se deri ka fundi i prillit duhet me i krye të gjitha punët që i kanë aty, por në kohën e fundit i kemi bërë edhe disa kërkesa në bashkëpunim me BE-në dhe me “Dakin Kompani”, për mi bë disa ndryshime, p.sh.: zëvendësimin e tepisonit me laminat etj.

z.Hasan Aliu: Po bëj përpjekje për pyetjet të cilat u parashtruan, të cilat bien në domenin e Kryetarit të Komunës. Unë besoj se pjesën dërmuese të pyetjeve morret përgjigje nga drejtorët, megjithatë ishte një kërkesë e këshilltarit komunal, caktimin e lokacionit për ndërtimin e një xhamie. Unë konsideroj se duhet ti drejtohesh Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Gjeodosisë dhe Kadastrit për hulumtimin e gjetjes së një lokacioni. Mirlinda rreth personave me aftësi të kufizuar, ne kemi bërë përpjekje për gjitha shoqatat të bëjmë zgjidhje, por megjithatë nuk kemi mund të bëjmë për shkak të buxhetit, megjithatë unë mendoj se na kemi lëvizur nga vendi dhe i kemi ndihmuar materialisht edhe kemi intervenuar edhe në rrugë, edhe aty ku ka pasur nevojë që të ja u lesojmë jetën atyre. Te konkursi për bursa, po të tregoj se kohëve të fundit kam bërë përpjekje edhe unë që ta shty atë proces, unë i kam informatat se ende UP-ja nuk i ka shpall emrat e përfitueseve të bursave ende dhe kjo po na pengon. Bekim, ne kemi një person që i përcjell punimet e ujësjellësit edhe në Smirë edhe në Verban, çështjen e kanaleve, çështjen e shtrirjes të gypave, ndoshta është afër asfaltit, por ato megjithatë duhet të shtrihen. Çështja e asfaltit, të trashësisë, nuk është aspekt profesional, ajo është çështje e ingjinerave të cilët duhet të marrin atë përgjegjësi për ato punë të cilat i bëjnë. Bekimi edhe Adnani e shtruan një çështje, unë besoj se të dy e dinë mirë çështjen e themelimit të kompanisë, edhe çështjen e partneritetit publik privat, nuk e ka bë Kuvendi e ka bë dikush krejt tjetër, prandaj na mund të mbajmë seanca të pareshtura, por

tejkalim të situatës nuk kemi, përndryshe po ju njoftoj, se ne si ekzekutiv jemi pandërprerë tu punua në atë drejtim, kemi pas takime, bile në mesin e tyre në takim të fundit më ka shoqëruar edhe kryesuesi për tejkalimin e situatës edhe përmirësimin e gjendjes. Bislim, një çështje duhet me pas të çart, besoj që pajtohesh edhe ti, qdo televizion nëse ka lëshuar shkresën është mirë ta ketë edhe kabineti i kryetarit, se gjitha televizivet që operojnë në Kosovë dhe ato lokale në aspekt ligjor duhet ta informojnë Zyrën e Informimit dhe Zyra Informimit i lajmëron ata të cilët do të bëjnë intervistat e tyre. Bakia i shtroj dy pyetje të cilat janë shumë me rëndësi, është e vërtetë se u nënshkrua një memorandum, unë nuk e di që kanë qit mediat, por e di se kërkesa është kanë për dy stadione, për shkak se ne nuk mund të bëjmë përjashtim të një ekipi që nuk kooperon në qytetin e Vitisë po është në kuadër të Komunës së Vitisë dhe te dyja ekipet garojnë të njëjtin rang garash dhe unë mendoj se te dy klubeve duhet të ja rregullojmë stadiumet për shkak se edhe standardeve që kërkohen nga FFK-ja dhe do të veprohet për të dy njëjtë, dhe pyetja dytë, e cila u shtrua për parkun në Kabash. Ju e dini se ne ju kemi kushtuar shumë hapësirave publike, duke filluar prej qytetit të Vitisë dhe nëpër lokalitete, aty ku ka pasur mundësi në këtë drejtim ne kemi punuar edhe në Kabash, por duhet ta kemi një të qartë, se gjitha kërkesat që burojnë nga qytetaret nuk mund të realizohen, nuk kam informacion për këtë vit a është parku i Kabashit.

z.Daut Xhemajli: Kërkoj falje se po e marrim kohen pak ma shumë se duhet, unë e kam një shqetësim lokalist, i ka dy vite që jam interesua për do pengesa në rrugë të Beguncës, me u rregullu, kurrë nuk janë rregullu ose janë rregulluar edhe ma keq. Tash kam një kërkesë, se ato definitivisht të hiqen, se pengesa të tilla nuk kam parë në lokalitetet e Komunës edhe nuk duhet me u kanë ose të rregullohen sipas standardeve. Një tjetër shqetësim që desha me marr kohë, është një reagim që e kam lexu prej DKRS-së për këto moralitet, është një shqetësim që mu ka dok shumë i drejtë dhe shumë me vend, po sikur e ka marr gjithë përgjegjësinë drejtoresha që nuk i takon. Unë mendoj, se këto institucione, kjo komunë më në fund duhet me tregua që institucione ka përgjegjës, unë mendoj se këto dukuri që janë ende prezent në Viti, këto prishje, këto uzurpime, këto shkelje të rënda duhet me u pengu urgjentisht jo proceduralisht e me shkua me vite edhe njerëzit me ra në pozita të kqija, që me një formë me u dok kishe po pengojmë dicka edhe mos me pengua kurrë ato janë dëmtuar kthimi i tyre në gjendjen afarë kanë qenë me këto institucione me këtë nivel të përgjegjësisë është i pamundur.

Kryesuesi: Faleminderit z.Daut, shqetësim i ngritur me vend, unë e di se organet kompetente kanë reaguar për këtë çështje, besoj se edhe drejtoresha do ta merr fjalën rreth këtij rasti.

z.Kaltrina Sylejmani: Faleminderit këshilltarit Xhemajli që ngriti këtë çështje, unë prita edhe ma herët se dikush prej këshilltarëve do ta ngris këtë çështje, por askush nuk e ngriti si shqetësim, i cili është shumë me rëndësi, sepse është dëmtim i pronës publike dhe përvec saj është edhe dëmtim i trashëgimisë kulturore. Mua më vjen shumë keq, se ende pa i bërë dy vite kjo vepër arti është dëmtuar nga një person tepër i pa përgjegjshëm dhe mendoj se kjo është kulmi i papërgjegjësisë, i hipokrizisë dhe i poshtërsisë, dhe unë mendoj se këtë çështje do ta trajtojë me përgjegjësi dhe unë ju paralajmëroj edhe juve, që kundër kësaj dukurie unë do të ngreh kallëzim penal, ku kam kërkuar edhe prej avokati të komunës dhe besoj se këtë kallëzim penal do ta adresojmë në Prokurorinë e Shtetit.

z.Skender Ahmeti: Këtë shqetësim që e ngritën parafolësin, ne vetëm se kemi marr masa, prandaj ne si qytetar jemi të bindur se punojmë në vikende dhe pas orarit të punës, por kjo ka qenë një rrënim që nuk mund me e ndal askush, edhe pse unë kam kërkuar nga stacioni policor të merren masa në këtë rast. Në momentin se kam dëgjuar edhe vikendin para një jave edhe në këtë vikend që ka ndodhur kjo dhe për këtë kam ngrit kallëzimin penal dhe kemi ndërpre edhe punimet, por megjithatë na do t'i ndjekim vetëm procedurat, por po lidhem te fjala e këshilltarit kur thotë "të mos qelet udhë". Gabimi fatal dhe trashanik i pafalshëm në historinë e shekullit XXI në institucionet e shtetit të ju jepen bizneseve private, të mbyllen bibliotekat në shtëpi të kulturës e të ju jepet njerëzve vetëm me bë biznes, kjo është paradoks i llojit të vet dhe i pa falshëm.

z.Daut Xhemajli: Ndoshta e keqkuptova drejtorin, po problemi është drejtor nëse e ke për lokalin, këtu kjo pjesë e bibliotekës nuk ka qenë asnjëherë, ka qenë hapësirë publike me shtylla, nesra i kalon kontrata mundet mos me ju vazhdua, problemi është ma i madh që ajo kontratë nuk zbatohet, ajo kontratë nuk mbikëqyret, ai person nuk paguan e shfrytëzon hapësirën. Ne kemi uzurpime klasike mes qytetit, ndjekni ato, zbatoj këto kontrata që i kanë njerëzit, unë nuk thash me i ruajt ato, kemi edhe në qendër të Vitisë që nuk lejojnë as me ble as me shitë, po ju lejojmë matrapazëve, uzurpatorëve, banditëve me sundu në këtë Viti.

Kryesuesi: Faleminderit gjithëve, tash po kalojmë në pikat e rendit të ditës. Për këtë seancë kemi paraparë këtë:

Rend ditevc

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së të Vitisë.**
- 2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e autorizimit e kushteve për borxhin afatgjatë nga Qeveria e Austrisë dhe miratimin e projektit për furnizimin me ujë dhe rregullimin e kanalizimeve për të gjithë qytetaret e Komunës së Vitisë si dhe rehabilitimin dhe rregullimi i shtratit te lumit Morava dhe shtrimi i rrugëve fushore**
- 3. Propozim vendim për bartjen e mjeteve nga te hyrat vetanake të vitit 2015 dhe 2016 në vitin 2017.**
- 4. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës Kompanisë KKDFE sha KEDS J.S.C për vendosjen e trafave elektrike.**
- 5. Propozim vendim për rregullimin e komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e sajë.**
- 6. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin të vendimit me Nr. 01.013/93 të datës 30.01.2017 për planin rregullues të hollsishe zona ekonomike me statusin "Parku industrial" në fshatin Budrikë e Epërme.**
- 7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2016**
- 8. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2017.**
- 9. Informatë nga drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë për Planin e Mobilitetit Urban.**

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm? Pasi nuk ka e hedhi në votim. Konstatohet se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së të Vitisë.

A ka dikush rreth procesverbalit? Pasi nuk ka e qes në votim për miratim. Konstatohet se me vota unanime u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e autorizimit e kushteve për borxhin afatgjatë nga Qeveria e Austrisë dhe miratimin e projektit për furnizimin me ujë dhe rregullimin e kanalizimeve për të gjithë qytetaret e Komunës së Vitisë si dhe rehabilitimin dhe rregullimi i shtratit të lumit Morava dhe shtrimi i rrugëve fushore

Fjalën e ka drejtori.

z.Ibrahim Rama: Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Është fjala për këtë propozim vendim për Komunën e Vitisë, që kërkon me aplikua në huamarrje financiare, një kredi të butë për nevoja të implementimit të projektit që do të zbatohet në Komunën e Vitisë. Kjo ide e këtij projekti ka fillua që nga viti 2012, d.m.th si projekt i aplikimit të komunave të Kosovës me Republikën e Austrisë. Marrëveshja mes këtyre dy shteteve është lidh me 5 qershor të vitit 2012, ku komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë në kuadër të financimit të projekteve. Me këtë vlen të ceket se Ministria e Financave ka mundësi të garantoj për borxhin e komunave, të cilat kanë nevojë për projekte të caktuara, edhe na kemi bërë kërkesë me aplikim përmes Ministrisë së Financave, për me na i mundësuar që na me pas qasje, me përgatitë dokumentacionin për kërkesë për kredi afatgjatë në Qeverinë e Austrisë. Për mos me ju marr ma shumë kohë, materialin e keni para vete, gjithashtu edhe hartuesi i këtij projekti do të ju shpalos nëpërmjet sllajdeve gjithë atë çka do të punohet në këtë projekt.

z.Sokol Haliti: Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Është fjala për një projekt për një kredi të butë që nivel qeveritar vec shumë komuna tash kanë apliku komuna jonë, është në bllokun e parë prej komunave që ka apliku dhe që ka marr pëlqimin prej Ministrisë së Financave dhe nga kryeministria është Komuna e Rahovecit, e Shtimes, e Gjilanit, e Podujevës, e Vitisë dhe Kamenicës, jemi 6-7 komuna në rundin e parë, është komponenta të cilën ne e kemi vlerësuar që është e nevojshme, kemi pasur në aspektin higjieno-sanitar, problematika kryesore ka qenë me kanalizime në gjithë territorin e komunës dhe grumbullimi me një vend dhe sigurimi i ujit të pijes cilësor për gjithë banoret, është fjala për një fabrikë për 100 litra në sekondë. Vitia në bazë të numrit të banorëve që i kanë rezident i duhen 80 litra në sekondë për kokë banori, masandej janë edhe disa aspekte tjera, rrugët rurale për shkak se implementimi i këtij projekti natyrisht nevojitet edhe rehabilitim i aspektit se ka shkojnë kanalet, është kompania që nëpërmjet sllajdeve do të ju prezanton, por unë vetëm desha të ju lus, që ky projekt ta merr vizën që të vazhdoj tutje.

Përfaqësuesit e firmës projektuese PRO ING bëjnë prezantimin nëpërmjet sllajdeve për këtë projektin për furnizimin me ujë dhe rregullimin e kanalizimeve për të gjithë qytetaret e Komunës së Vitisë si dhe rehabilitimin dhe rregullimi i shtratit të lumit "Morava" dhe shtrimi i rrugëve fushore.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

znj.Mirlinda Sadiku: E kuptoj se është një projekt kapital, por megjithatë kam disa mëdyshje. Atë ditë inxhinieri kur na i prezantoi na tha se gjatë projekteve gjithmonë ju jap përparësi ujit të pijes dhe sistemit të ujitjeve, ndërsa sistemi i ujitjes nuk është paraparë në këtë projekt kur e dimë se një pjesë e madhe në Viti merren me bujqësi, prandaj sistemi i ujitjes është kanë mirë të parashihet në këtë projekt, për arsye se kostoja e derivateve është kocko e lartë. Më intereson ta di

sa është evidentuar qoftë nga Komuna qoftë nga kompania. Gjendja aktuale e kanalizimeve ka lagje të cilat nuk janë fare të kyqura kemi kanalizimin në Smirë, që shumë herë është debatuar në këtë Kuvend, që nuk është funksional, po ashtu njëjtë është edhe në Tërpezë, e kam argumentua se edhe tri lagje nuk janë në fshatin Skifteraj, d.m.th sa është bë një vlerësim real i gjendjes aktuale në Komunën e Vitisë për me mund me arrit një kalkulim përfundimtar që e keni bërë, po ashtu ka shumë ujësjellësa që nuk janë funksional, kemi p.sh.: fshatin Skifteraj, të cilin e kemi edhe ndaj KEDS-it, nëse nuk gaboj në vlerë prej 22 mijë euro, pastaj nuk janë funksionale ujësjellësit nëse nuk gaboj edhe në Beguncë, Zhiti. A është gjendja reale, a është bërë vlerësimi dhe kalkulimi në këtë projekt? Po ashtu shumë herë u cek këtu në Kuvend po i bëjmë gjithë këto investime tash po bëhet edhe ky projekt, komuna do të hy në borxhe, fëmijët tanë po i paguajnë ato borxhe, jo ne nuk e kemi një adresë që gjithë këto investime kapitale t'ia dorëzojmë një adrese, të caktojmë një kompani që do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e ujësjellësit edhe të kanalizimit, p.sh.: nëse njerëzit vazhdojnë të hedhin mbeturina në “Moravë”, ajo normal se do të paraqet problem, mjafton të shkoni në Budrikë dhe ta shini si është mbushur gjithë “Morava” me mbeturina e po ashtu kolektori, po cka nëse nuk do të gjenden donator edhe të krijohen ata kolektor që të pastrohen ujërat e kanalizimeve, prandaj është një projekt kapital, duhet të mendohet mirë kur të votohet, se është një diçka se involvohen edhe gjeneratat më tutje. Ajo se nuk më ka pëlqye është, se janë marrë shumë gjëra në të njëjtën kohë me 12 milion euro, shumë gjëra me u krye qoftë ujësjellës qoftë kanalizim, qoftë shtrimi i rrugëve bujqësore, prandaj mos ka qenë ma mirë të fokusohemi te ujësjellësi e një herë e përgjithmonë ta kryejmë si problematikë e jo të fillohet me 3-4 projekte e në fund mos të mbërrihen që të kryhen të gjitha.

z.Sokol Haliti: Kërkoj falje, po këtu u ngritën shumë pika, secila ka përgjigje në veti. Sistemi i ujitjes është temë në vete e kanalizimit, është temë në vete e ujësjellësit, raporte të “Hidro Moravës”, po mirë është me ditë “Hidro Morava” qfarë funksioni ka, se merret edhe me aspekte të tjera në fund kjo ka me hy në funksion se ne kemi marrëveshje, por investimet që ne i kemi kërkuar nga investitori austriak në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës. Këto investime nuk mund me i bë “Hidro Morava”, prandaj këto investime nëse i realizojmë se ne në rend të parë jemi duke i bërë detyrat e shtëpisë që me fillu me realizu nëse e realizojmë, atëherë ne zyrtarisht ulemi edhe e diskutojmë dhe kalon në kompetencat e kompanisë, se me ligj është e rregulluar se çështja elementare, se na duhet me ditë edhe këshilltaret edhe qeveria komunale po edhe qytetaret. Sa i përket aspektit të sistemit të ujitjes, nuk ka nevojë me diskutua me lidh me aspektin e ujit të pijes, ju këshilltar nëse jeni ekspert të kësaj lamie mundeni me dhënë kontributin pa problem. Sot emergjent ishte projekti austriak, me të cilin qe një vit e gjysmë jemi duke u marr, ky është ende projekt ideor dhe unë mirëpres në këtë projekt sugjerimet e juaja, ndërsa rrugët fushore e kemi patjetër për arsye se nuk gjatë shtruarjes së rrjetit duhet të ndreqtë rruga, sepse dëmtohet, ne do të shkojmë përreth “Moravë”, që lidhet me Zonën Ekonomike në Budrikë, këto janë projekte makro, nëse i investojna na këto projekte sfida nuk do të kemi ma në Viti, jemi afër kësaj, e shohmi dritën në tunel, punojnë bashkë, në këtë kuptim është mirë me u fokusua vërtetë. Tjetra, e kam thanë edhe ma herët, ujësjellësi në Skifteraj, në Zhiti ka kalua, kanë kaluar procedurat, tash ka mbet vetëm me fillu punimet. Unë po thamë se ti i ke zbuluar tri lagje, unë po them se janë 36 lagje dhe sipas krejt këtyre që kam identifikuar kena shumë që kanë nevojë me u intervenuar edhe në kanalizime. Ne e kemi lut Qeverinë Austriake që me na i dhanë në kredi të butë, që mos të merremi ma me “Moravën” me ujë të pijes etj.

znj.Mirlinda Sadiku: Për asnjë moment nuk e ceka fushatën zgjedhore Kryetar, por unë kam drejtë me pas drejtë të skepticizmit, këtu janë katër projekte brenda një projekti dhe mua ma merr mendja, se brenda kësaj kornize diskutova edhe po ta përkujtoj Kryetar, se atë ditë në KPF ka

thanë pikërisht inxhinieri që e ka formuluar këtë projekt, që ky është projekt që garanton për 25 vite jo për 100 vite si thatë ju, edhe asnjëherë nuk jam kundër kësaj që është në të mirë të qytetareve mos me votua. Sa i përket lumit “Morava”, s’besoj që është dikush që ka ngritë çështje që kanë bërë dëme, prandaj kam të drejtë me pas një dozë të skepticizmit, është e drejtë e imja tek e fundit nëse ma mbush mendjen se është dicka në të mirë të qytetarëve, pse jo, por me i bë katër projekte madhore në të futer me një projekt në vlerë prej 12 milion euro është problem.

z.Sokol Haliti: Ti ke ngrit çështjen e “Moravës”, por unë e kam ndreq, ky është dallimi dhe është shumë i madh. Në vitin 2007 kur kam qenë drejtor, unë e kam qua projektin për rregullimin e “Moravës”, nëse mendoni se bani barabarësi me ngritje çështjesh edhe me punë, harrone se këtë nuk mund ta bëni, se qytetari e dinë edhe një gjë, po të them unë i kam 12900 vota, unë e kam votën e qytetarit, prandaj ma së pari e kam detyrimin për gjithmbarshëm për qytetaret e Komunës së Vitisë, sepse po krijoni kufi të barabarësisë, ndonjëherë edhe po duhet me ta thanë se dallimi është shumë i madh edhe në legjitimitet edhe dallimi i madh është në kryerjen e punës, por unë po ju lutëm të punojmë së bashku edhe ndihmonëm edhe ta ndreqim “Moravën” si duhet, unë nuk e di qsa të ka than ai djali në KPF, por unë një po të them, këtu ka profesionalista që 100 litra në sekondë ujë sigurojnë për 100 vite ujë, për 100 mijë banorë në Viti, 80 litra ujë në sekondë, na duhen neve 40 litra në sekondë i kemi të siguruara po ajo çështje është tjetër. Këtu duhet me bë dallimin, se ne jemi duke folur për ujë të pijes jo për sistem e ujitjes.

znj.Mirlinda Sadiku: Kryetar, legjitimiteti i votës, votë ke ti, votë kam unë, por ne krejt s’mund të kandidojmë për kryetar. Sa i përket “Moravës”, i pari që e ka kthye kryet ka qenë Tom Hajdari, ministër i AAK-së, nëse flas flas me argumente kam të drejtë të shprehu mendimin tim.

z.Sokol Haliti: Unë nuk e marr modelin e askujt, unë jam origjinal, unë kam kulturë të diskutimit, nuk e kam së pari unë qe 30 vite në aktivitete, dhe the di, unë jam person publik dhe qsa të kish urdhëro lirisht na këtu jemi duke folur për një projekt, ti tërë kohën i qet prej kontesti.

z.Bekim Azizi: Unë do të jem, jemi pjesë e temës, por çështja e legjitimitetit cdo njëri që e jemi këtu e kemi legjitimitetin, nuk besoj se është mirë të bisedohet kjo çështje, besoj se secili e ka vendin e vet, i ka kompetencat e veta, i ka detyrat e veta, janë të ndara detyrat e ekzekutivit edhe të Kuvendit, nëse na nuk e votojmë buxhetin, nëse na nuk e votojmë projektin, këtë projekt kryetari vetëm mund me mendua që është, por nuk mund me realizu, sepse ajo është kompetencë e jona e nuk është mirë na këtu me diskutu për legjitimitet, se secili i dimë punët e tona. Na nuk mundemi te ekzekutivi Kryetar, se ato janë punët e tua. Çështja e projektit që jemi duke e diskutuar tash, marrja e kredisë prej 12.2 milion euro për mua edhe në KPF e kam than orientimi që është bërë edhe në kanalizim, edhe në ujësjellës, edhe te lumi, edhe në rrugë fushore është e gabuar, asnjëra prej këtyre katrave nuk garanton një punësim, nuk garantojnë një qasje të zhvillimit ekonomik. Na mendoj se duhet me hy në kredi për një çështje ku garanton vend të punës, kur një çështje i jep zhvillim ekonomik, çështjet e ujësjellësit dhe kanalizimit që 17 vite është duke u investuar në to, na me projekte për një katund, ai projekt nuk na ka dal mirë e leje me u bë mirë një projekt për 50 mijë banor, absolut nuk e shohë që do të bëhet, mirëpo me hy me marr kredi prej Austrie me i shtrua rrugët me zall valla kjo është keq edhe me bisedua me hy në kredi, me i shtruar rrugët e arave me zall, kjo është keq. Unë e di se kjo kredi është afatgjate edhe kredia lahet nga të hyrat vetanake dhe diku 60% të hyrave vetanake mi shti në kredi është një ngarkesë për Komunën, është një ngarkesë për 5 qeveri komunale, se kjo bëhet për 20 vite. Unë nuk e shoh se ka me funksionuar mirë ai, ndoshta nuk na i japin hiq këtë kredi, mirëpo nuk e kam parë një qasje të mirë diku 85 litra ujë mi marr prej “Morave” kur na e dimë se aty e kemi dhanë edhe një leje që është duke u ndertuar një hidro central, aty ka vende të punës, kanë me punua njerëzit edhe na në momentin që i marrim qato 85 litra ujë është problem, mes të verës edhe lumi “Morava” me ja marrë këtë sasi ka mu tha,

nuk ka me pas ujë, se ma Hydrocentralit nuk ka mi shkua as një pikë ujë aty, nuk e shohë se është bërë orientim i mirë, se këto kredit janë bërë modë prej komunave me i marr, mirëpo nuk jam tu e pa se mundemi me ba një punë të mirë. Komuna e Pejës ka aplikua për kredi për turizëm, besoj se e dhe ne kemi mundë me bë këtë, se e jep mundësinë, a me hy 12 milion kredi për ceva të kanalizimit, valla për mua nuk po e shohë që është në rregull.

z.Sami Demelezi: Një propozim vendim mendoj mjaft i qëlluar, që na jem pro na grupi i këshilltarëve të LDK-së e kemi mbështetur, kemi dhanë kontributin tonë edhe në KPF po edhe këtu para jush po e shprehim përkrahjen tonë. Kisha me u ndal te shuma prej 12.2 milion euro, totali i projektit është llogarit konsideroj vite më parë, kur nuk e kemi pasur këtë infrastrukturë që kemi sot, ndërsa, në vitet që është bërë paralogaria e tyre, ne sot kemi një infrastrukturë kryesisht shumë ma ndryshe sa që ishte, prandaj ato mjete që janë paraparë për rrugë fushore si dhe kanalizime, ujësjellës, që janë avancua shumë, do të përdoren për projekte të tjera, prandaj këtë se e tha z.Bekimi, edhe për turizmin mundemi si Kuvend, nga kjo shumë e këtyre projekteve që janë kryer mund të shtiem edhe atë, prandaj unë konsideroj se do të ishte përparësi shumë e madhe nëse mundemi me ardhur deri te përfitimi i kësaj kredie, që ende nuk e kemi të sigurt që do ta marrim. Kam bindje të fortë, se lokalitetet e tona do ta mbështesin shumë kur dalim në debat këtë propozim vendim, prandaj duke u bazuar në këtë, ne këshilltarët e LDK-së jemi pro këtij propozim vendimi.

z.Daut Xhemajli: Tu e pas parasysh që kjo me një formë është vetëm hapje e rrugës për me aplikua ose me konkurrua për një kredi të tillë, është hipotetike me thanë që sikur po e marrim pa e ditur se a po e marrim a jo, por mbi gjitha është me rëndësi interesi i qytetarëve, i komunës tonë, për me realizua projekte edhe punë, punë të cilat me një buxhet të komunës qysh e kemi nuk mundemi me i krye. Në këtë aspekt unë edhe në KPF e kam cek këtë, detyrat për firmën e projektit kanë qenë shumë përfshirëse dhe mendoj se është dashtë me u kanë ma konkret, mos me e përfshi çështje që ndoshta janë sekondare karshi asaj primares. Unë e di se duke hapur një kanalizim ne mund ta dëmtojmë një rrugë me prish diçka, e në kuadër të kësaj nuk ka qenë dashtë të përfshihen në titullin e projektit kjo puna e shtrimit të rrugëve fushore, ndoshta edhe te kjo kanalizimi i ujërave atmosferik, se tu pas parasysh që janë projekte që komuna me buxhet të vetin ka mundësi me realizu, komuna nuk ka mundësi me bë kanalin kryesor të rrjetit të kanalizimit për shumë vite. Në këtë aspekt unë e mbështes këtë ide, këtë projekt, që projekti për kanalizim të ujërave të zeza, sidomos kanalit kryesor edhe të pjesëve lidhëse që janë duhet doemos do të përfshihen si prioritet numës një, tjerat krejt komunat mundet me i bë, por me bë kanalin kryesor jo për 25 vite qysh është thanë po për nja 100 vite së paku. Këtë aspekt unë mendoj se projekti i kanalizimit duhet të rishqyrtohet, diametri keq është, se kur ta qojmë në Budrikë nuk kemi menduar çka masandej. Normal duhet me bë zgjidhje, në këtë aspekt unë jam pro dhe përkrahu projekte serioze. Për çështjen e ujësjellësit, po e them edhe këtë, nëse i lami kanalizimet pa mbikëqyrje, pa pagesë, jo kanali fi 200, por hiq kanal nuk ka që i përbien këto sende, d.m.th problemi është, se qytetari jonë edhe në këtë aspekt edhe obligim i joni institucioni ma së pari duhet të vetdijësohet që duhet të paguaj për kanalizim, për ujësjellës, për mbeturina etj. Për ujësjellës unë kam than edhe në KPF, duhet ajo mundësi alternative edhe prej Letnicës edhe nga Kurbliqi, e kem përmend se ka Kurbliqi ne kemi bërë ndërhyrje të projektit, është kanë menduar penda, letë mund me inkorporua në ujësjellës. Kjo puna e hidrosistemit nuk e di qysh ka me mund me u inkorporu, masanej mundet, po tash për tash nuk funksionon, janë të pa koordinuara mirë edhe çështja që mendoj që është ma delikate, që nuk ka lidhje me projektin si detyrë, por të hyrat vetanake të komunës sonë nuk e di a na lejojnë me hy në këtë shumë të kredisë. Kam përshtypjen se nuk mund ta mbërrinë me këtë nivel të të hyrave edhe si rrjedhoj ka mundësi qeveria me than nuk mundeni me hy 12 milion po mundeni me hy deri 6 milion, sepse nuk lejohen të hyrat vetanake me u përdor ose me hy kredi ma

shumë se gjysma e tyre, prandaj e thash që kjo është vetëm për me apliku, unë jam për me hap rrugë, po paraprakisht ose pas kësaj komuna duhet me qenë shumë serioze në hartimin dhe detajizimin se qa jemi duke dashtë me bë.

z.Ali Bajrami: Unë do ti referohem direkt këtij propozim vendimi, që ka ardhur direkt prej Zyrës së Kryetarit. Ky propozim vendim, që për Komunën e Vitisë vlera prej 12.2 milion euro është një projekt kapital, që nëse dalim dhe i shikojmë mundësitë për investime kapitale, për 5-6 vite këto mjete do ti shpenzojmë dhe sa do ti kryejmë punimet që i kemi, puna që është bërë ka filluar me 25 maj të vitit 2015, krejt kjo punë cka është bërë u bë me ardh kjo në aktin final, që ne si komunë dhe si Kuvend Komunal ta japim vizën për marrjen e kësaj kredie prej Qeverisë Austriake, që është shumë e volitshme për mendimin tim, duke marr parasysh ajo se interesi është zero, grejs periudha është 6.5 vite, afati kohor prej 22 vite, që është afat kohor i gjatë dhe komuna besoj se me këtë trend që është nuk do të vie në pikëpyetje kthimi i kësaj kredie, akterët që janë në lojë sa i përket kësaj kredie, Komuna e Vitisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Financave e Qeverisë Austriake, mendoj se janë shumë serioz dhe realizimi i kësaj kredie nuk do të vijë në pyetje, vetëm kisha dashtë të kemi atë fat që ne ta marrim atë shumë, se me marrjen e kësaj kredie dhe votimi jonë pro kësaj kredie na bënë që edhe na si asamblistë, që e kemi votën e qytetarit, sa po bëjmë dhe sa jemi duke dhënë llogari ndaj atyre se na kanë votuar. Shuma 12 milion, nëse e kthejmë në vite bënë 264 muaj, diku kësti mujor është 45500 euro nëse zberthehet kjo në vlerë vjetore është 544450, nuk është e pa përballueshme, dhe pa problem do ta kthejmë si komunë këtë obligim që do të hymë. Mënyra e realizimit e kolektorëve është mirë e mar, se do ti grumbullojmë të gjitha ujërat se po përmendet impianti po pa kolektor, na nuk kemi si ti grumbullojmë deri te impianti, prandaj po impianti kushton, por ne i kemi krejt me një vend të grumbulluara e kemi shumë ma letë edhe donatorin për impiant.

z.Bislim Bislimaj: Mua po më doket gjithë ato probleme që po i sjellim na këto grindje që po i bëjmë mes vete, po rrjedhin si pasoj e asaj, që na nuk kemi një program të caktuar për strategji të caktuar, se cka i nevojitet Komunës së Vitisë si prioritet. Shumë herë e kam cek edhe prapë po e cek, po e përmendni sovranin, po ai na i ka dhanë neve votat për me mbrojtë atë, si ta mbrojmë ne në këtë mënyrë, kur ky projekt na kushton, kjo është hua marrje, po edhe këtë hua marrje nëse nuk e shfrytëzon si duhet dhe nuk shkon aty ku duhet ajo e humb kuptimin, i shpenzon dikun për qëllime krejt tjera, edhe pse kanë nevojë, mirëpo për zhvillim këtu nuk kemi të bëjmë me zhvillim këtu kemi të bëjmë me nevoja elementare na si komunë, qat mentalitet se e kemi gjeneratë pas gjenerate duhet ta hekim prej mendje edhe me i orientua ato pare aty ku duhet me shkua edhe ku mund me përfitua prej tyre pareve. Një digë për Komunën e Vitisë ka qenë shumë e rëndësishme atë digë e kanë përmend kuvendet e ma hershme, bile kanë bërë edhe projekte, ajo digë sigurisht do të kishte me bë edhe ujitjen e tokave, përmes ujitjes së tokave qytetari paguan taks ma tepër. Na po e marrim problemin prej bishti nuk po e marrim prej koke, edhe po më vjen qudi pse na si Komunë që kemi gjithë këto mundësi, se ajo digë kishte pruar menjëherë edhe turizmin. Unë e pash një shumë të ujësjiellit prej Letnice, ishte 500 e 50 mijë euro a qe 3,5 vite e kemi përmend që mi hekë ata gypat e azbesit që janë tu e dëmtu shëndetin e banorëve të Vitisë.

z.Samet Idrizi: Desha një pyetje për projektuesin e këtij projekti, se ma shumë është mirë prej asamblistëve është që mu fokusua qa afron ky projekt ideor. I nderuar projektues: a ka mundësi me dal te përshkrimi i projekteve, ku i pate diku 7-8 pozicione? Deri sa ta gjen projektuesi, unë mendoj se fokusimi u kanë mirë me u bë dhe duhet me u bë mendoj se nuk është vonë hala te shtimi kapacitetit të ujit te rrjeti i ujësjiellit deri me një masë, se edhe ashtu e kemi Qeverinë Zvicerrane që është duke investua në rehabilitim edhe në zgjerim edhe në rrjete të reja të ujësjiellit edhe te impianti, pastaj pastrimi i ujërave të zeza, u kanë mirë me u fokusua vetëm në këto çështje,

jo me u zgjerua ma shumë. Rrugët me zhavorr, unë po mendoj se kemi kapacitet vet me i shtruar Komuna, se kemi gurëthyes bukur shumë në Komunën e Vitisë, mua më intereso shtimi i kapacitetit të ujit të rrjeti sekondar, këtu përfshin sigurisht gypa të profilit ma të vogël. Furnizim me ujë, gypi i furnizimit shpërndarës në rrjetin sekondar. Te rrjeti sekondar, këtu përfshihet sigurisht gypat të rrjetit ma të vogël, furnizim me ujë rrjeti i furnizimit të rrjetit primar që qa përfshihet me na i sqarua ma gjerësisht ju lutëm. Edhe një pyetje, në rast se e fitojmë këtë kredi, mjetet kush do t'i procedoj, kam dëgjua se huadhënësi na inponon disa furnizime nuk e di sa është e vërtetë, tash është mirë me ditë edhe atë na, është shumë me rëndësi, se ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza me qenë tamam impiant, jo vetëm kolektor, se ata nuk janë aq të suksesshëm. Për mua ka qenë më e rëndësishme me bë një aneks fabrikë, ku i kishim shtua kapacitetin e ujit edhe 40 litra në sekond, se me “Moravë”, atje mundemi me pas problem, edhe përfundimisht nuk po dua me fol ma shumë, se vetëm po përsëriten këto qëndrimi i grupit të PDK-së për këtë pikë është neutral, ne si grup do të abstenojmë.

z.Sokol Haliti: Me shumicën e diskutimeve përveq se e tha Sameti pjesës politike që po i jepmi nganjëherë ndoshta e kemi diskutuar shumë por kur ki parasysh se ky është projekt i madh makro është projekt senzitiv a është zhvillimor a nuk është na nuk mund me i thanë që nuk është zhvillimor pa ujësjellës edhe pa kanalizim nuk mund me pas zhvillim ekonomik a bënë punësim a nuk banë jashtë kësaj shërbimet publike bëjnë punësim por këtu nuk është puna te punësimi këtu është të bohet zgjidhja e një problematike që është gangrene për qytetaret e Kosovës sidomos për Letnicë edhe tash a është fillestare është po a ka bë pa e kalua na nëpër procedura qeveri komunale në KPF në Kuvend a banë pa e lëshua në debat me ekspert të lëmire por krejt këtu janë në vazhdim që ne duhet me i diskutua edhe a e kemi të sigurt këtë qa e marrim që e kemi kërkuar nuk e kemi , kypi i asbesit un nuk e përmenda për arsye se nuk ishte ne agjendë gypat janë ble prej Letnice deri në Viti me u ndërrua nga CDI-ja Zvicerriane ne gypat i kemi tash ka me mbetur me u tenderua vetëm kanali për shkak se faza e 5-të e projektit Zvicerrian për ujin i pijes në Viti përfshinë Smirën , Vorban , Stubllën dhe përfshin gypin prej Letnice deri në Viti ju e diskuat shumë rrugët me zhavorr ne e kemi cek ato se gjatë punimeve dëmtohen rrugët me këtë që e kemi cek duhet të rivitalizohen , kjo është mendoj modeli ma i mirë që ne ta aprovojmë por me hy na po e tham edhe një na jemi ndër komunat e para që kemi konkurruar sa ka qenë Besim Beqaj ministër e kam iniciua këtë pastaj u ardhur Avdulla Hoti e kemi diskutuar edhe me të i pari e kam marrë pëlqimin për këtë nga kryeministri i asaj kohe z.Hashim Thaqi këtë e ka në dokument edhe drejtori .

Kryesuesi: Pasi nuk ka tjerë për të diskutuar e hedhi në votim që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës kush është pro kësaj pike ju lutem me ngritje dore ; me 18 vota pro dhe 7 abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës si pikë tjetër të rendit të ditës kemi ose me pëlqimin e juaj drejtoresha Fatbardh e ka një pikë por pasi ka një takim a ishte mundësia që kjo ta prezantoj pikën një herë faleminderit pra si pikë tjetër kemi:

3. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës Kompanisë KKDFE sha KEDS J.S.C për vendosjen e trafove elektrike

Ja kisha dhanë fjalën drejtoreshës rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Fatbardha Emini: Është një propozim i zakonshëm pasi qytetarët e Komunës së Vitisë vazhdimisht janë duke pasur kërkesa për furnizim me energji elektrike na e kemi sjell një propozim vendim para ju materialin e keni marrë me kohë nëse ka dikush ndonjë sqarim jam këtu të ju ndihmoj.

Kryesuesi: Hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm , nëse nuk ka unë po e qes në votim që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës : konstatoj se me vota unanime u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

4. Propozim vendim për bartjen e mjeteve nga te hyrat vetanake të vitit 2015 dhe 2016 në vitin 2017

Fjalën e ka drejtori rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Ibrahim Rama: Si zakonisht qdo vit komunës në fund të vitit i mbesin mjete të pa shpenzuara që barten në vitin vijues , keto i kemi cekur edhe në propozim vendimin që e kemi sjell para jush , kjo sipas ligjit për financat publike përmes kuvendit Komunal duhet të barten në buxhetin e vitit 2017 pa lejen e juaj këto mjete nuk barten , për ma shumë mos me ju marr kohë se propozim vendimin e keni para jush.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike a donë ta merr fjalën dikush, nëse nuk ka un po e qes në votim për miratim: konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

5. Propozim vendim për rregullimin e komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj

Meqenëse këtë pikë pik e kemi pas një herë në kuvend ja kemi dhanë vizën për me shkua në debat publik dhe pas proceduarave e kemi kthye në kuvend prapë që ta merr formën e prerë: hapim debat edhe rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: Te shkollat e kam parasysh që me pas zebra që me reflektua që kalojnë, po ashtu ju e kishi bë një zgjidhje për rrugën Kemajl Azizi që e kam ngrit edhe si çështje këtu në Kuvend mirëpo aty thuhet se kryetari i Komunës është marr vesh nëse ka mundësi një përgjigje, sipas planifikimit të kryetarit edhe zyra e projekteve do të ketë edhe një parkim për taksi në rrugën Kemajl Azizi a mundem me ditë ku u paraparë ky vend parkim ,po ashtu në fshatin Skifteraj është një vend ndalje në qendër të fshatit afër ambulantes edhe një afër përmendores së dëshmorit Hoxhë Januzi atje poshtë është edhe një vend ndodhje tjetër është te rruga 17 shkurti nalt atje nëse nuk është e cekur dhe nëse ndalet ka mundësi të dënohet po ashtu më intereson ta di se e kemi atje te rruga Adem Jashari te qendra afër mediteranit i kemi të parkuar edhe ata që presin drunjë a u paraparë diku ku të parkohet kjo shtresë punëtorëve.

Kryesuesi: Në mungesë të njerëzve kompetent të cilët u dashtë me qenë këtu dhe me na dhanë njoftimin në lidhje me pyetjet të cilat i parashtroni ju, unë e hodhi në votim që të që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin të vendimit me Nr. 01.013/93 të datës 30.01.2017 për planin rregullues të hollsishe zona ekonomike me statusin “Parku industrial” në fshatin Budrikë e Eperme

Edhe në KPF e kam sqarua këtë është ky një propozim vendim të cilin e kemi miratuar në seancën e parë të kuvendit por me qenëse u përvjedh një gabim teknik në preambulë e këtij vendimi ministria na ka sugjeruar ta kthejm edhe njëherë në kuvend ta përmirësojmë : kush është që të miratohet kjo pikë , konstatoj se me vota unanime u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi ;

7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2016

Unë vetëm po e falënderoj Nurën që kanë prua një propozim vendim të tillë diqka nuk kam me shtua , hapim debat rreth kësaj pike: a donë ta merr fjalën dikush?

znj.Mirlinda Sadiku: Janë dhanë shumë rekomandime se di sa do të përfillen edhe prej komunës besoj se ajo ma kryesorja është që komuna ta themeloj kompaninë mbi bartjen e mbeturinave është fakt se në Skifteraj dhe në Smirë vetëm se janë formua disa deponi të egra , qa me ra në sy është se kërkohet nga KKSJ-ja të bëhet presion tek stacioni policor në Viti dhe te komandanti , un nuk besoj se mundet me bë presion por vetëm mundet me dhënë rekomandime , me than të drejtë vendosja e policisë në bashkësi te shkolla ka qenë diqka shumë e qëlluar , dhe po më dukeni se po hyni edhe në kompetenca të DKA-së se thoni të bëhet kontrollimi gjithave shkollave rreth ngrohjes .

Kryesuesi: Nëse nuk ka tjetër kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi

8.Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2017

Është komitet gjithashtu që e kemi formuar ne një komitet obligativ i cili takohet në vazhdimësi po them se vitin e kaluar ka pas takime ma të shpeshta krahasuar në vitet paraprake kanë dhënë edhe këta rekomandime dhe propozime disa kanë qenë të arsyeshme por nuk kemi pas kompetenca siq ka qenë propozimi i tyre të ju shpërndahet të varfërve dru dhe një të drejtë të tillë nuk e kemi pasur por me gjithë atë e kemi adresua në vendet ku u dashtë me adresua me qenë kryetarin e komitetit këtu nuk e kemi, unë e kisha hap debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: Nëse më kujtohet mua në njërin nga seancat kolegu Vehbi Rama pat thanë se komiteti Kroat në Letnicë jetojnë në kushte shumë të këqija a është marrë diqka në atë drejtim a ka pas ndonjë iniciativ konkrete që jeta e tyre me u përmirësua brenda kapaciteteve buxhetore që i ka Komuna.

Kryesuesi: Nuk e kam obligative por jam shpesh prezent në aktivitetet që bëhen nga komuna e Vitisë dhe me Kryetarin komunës dhe nënkryetarin në vazhdimësi kemi bë përpjekje që sado pak të asaj kategorie të njerëzve që kanë mbetur të moshuar jemi munduar me ju ndihmua me pako ushqimore dhe higjienike , nevojat e tyre janë të mëdha sepse familjaret e tyre i kanë lënë dhe aty jetojnë vetëm një kategorie e të moshuarve.

z.Vehbi Rama: Unë u vonova pak po dal jashtë temës disa qytetar më informuan shumë gjëra elementare mungojnë po tash fatkeqësisht kish edhe ma keq në ambulanten në Pozheran kishte qenë e mbyllur le që nuk kish pas barna po nuk kish pas as mjek , sa i përket rendit të ditës komiteti për komunitete na mbajmë takime të rregullta ku është edhe kolegu Bislimi ku e cekim edhe kolegja Mirlinda fatkeqësisht është ndërmarr shumë pak në këtë komunitet sidomos me atë kroat që the i kemi ndihmua me ndihma humanitare por ne kemi qenë në teren dhe kemi thanë që ju mungon së paku nga një dhomë se jetojnë në kushte të mjerueshme, përpos atje jemi kanë edhe në Goden ku është një invalid pa shtëpi , pastaj kemi qenë në Pozheran edhe aty janë në kushte të mjerueshme komiteti shkali , ne kemi bërë kërkesë te kryetari për ndihma momentale ju ka dhënë disa familjeve por jo përmes komiteti po ju ka dhënë anasjelltas farefisnore apo partiake a na si komitet që i kemi propozuar ata emra asnjë emër nuk ka marr .

Kryesuesi: Unë kam qen një herë apo dz herë në atë komitet nuk jam obligative qenë se ju e keni edhe kryetarit e komitetit , dikush tjetër nëse nuk ka u po e qes në votim për miratim. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë të fundit kemi:

8. Informatë nga drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë për Planin e Mobilitetit Urban

Kjo pikë është mbështetur nga DEMOS-i, kanë dash që ta kemi këtë pikë edhe në Kuvend.

z.Nexhmedin Jakupi: Unë nuk kam qe me shtua ma shum të gjitha i keni të cekura në informaten që e kemi sjellur këtu para ju nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi jam për të ju ndihmuar.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës , a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm, nëse nuk ka u ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhanë në këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:25 min.

Procesmbajtësi:
Ilir Zuka

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira